



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 7/17
Prishtinë, më 08.11.2017, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhjen morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontic, Ali Lajçi, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Blerim Kuçi, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Munguan: Dardan Molliqaj dhe Mytaher Haskuka.

Pjesëmarrës të ftuar: Bedri Hamza - Ministër i Financave, Fehmi Mehmeti- U.D. Guvernator i BQK-së, Arben Mustafa nga BQK, Hilmi Jashari-Avokati i Popullit, Jashar Kastrati-sekretar i përgjithshëm IAP.

Pjesëmarrës të tjerë: Rejhane Zylfijaj-GIZ, Besmir Radoniqi-Praktikant, Valtrim Hasani Praktikant, Majlinda Doda gazetare e RTK-radio, Mehmet Simnica zyrtar në KMFP, Valbona Bytyqi gazetare në Ekonomia online, Semra Çitaku këshilltare për ekonomi-Ambasada britanike.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Kryetar i Komisionit – Lumir Abdixhiku.

R e n d i i d i t ë s

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 17.10.2017;**
- 3. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me Vendimin e Qeverisë për vendosjen e normës së tatimit të akcizës;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2016;**
- 6. Shqyrtimi i Raportit financiar të Avokatit të Popullit për vitin 2016;**
- 7. Shqyrtimi i Raportit financiar të Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016;**
- 8. Shqyrtimi i Propozimit të Komisionit për Përzgjedhje të anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës;**
- 9. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – njoftoi anëtarët e komisionit se Kryetari i Bordit të Auditorit Regullativ të Komunikimeve Elektronike, ka njoftuar se nuk është në Kosovë, prandaj propozojë që kjo pikë që është e shtata me radhë, të shtyhet për një mbledhje tjerë.

Kryetari konstatoi se komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës, me ndryshime: pika e 7 e rendit të ditës Shqyrtimi i Propozimit të Komisionit për Përzgjedhje të anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, shtyhet për një mbledhje tjetër të komisionit. Në vazhdim pika 8 dhe 9, bëhen pika 7 dhe 8.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e komisionit të datës 17.10.2017

Kryetari – konstatoi se procesverbali nga mbledhja e datë 17.10.2017 miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me Vendimin e Qeverisë për vendosjen e normës së tatimit të akcizës

Kryetari- sipas nenit 3 të Ligjit 03/L-220, për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr.03/L-112 për tatimin e normës së akcizës në Kosovë, Qeveria e Republikës së Kosovës në konsultim me komisionin mund të ndryshoj dhe të shtoj listën e mallrave që i nënshtrohen normës së tatimit të akcizës. Qeveria ka bërë një propozim për të ndryshuar, respektivisht liruar nga tatimi i akcizës, prodhuesit që importojnë burimet e energjisë të cilat përdoren për qëllime të prodhimit. Për këtë qëllim është ftuar dhe kërkojmë sqarime nga Ministri i Financave.

Bedri Hamza- theksoi se Qeveria ka marrë për vendim lirim të tatimit të akcizës të gjithë prodhuesit pavarësisht a importojnë vet apo përmes kontraktorve burimet e energjisë të cilat përdoren si lëndë ndihmëse në procesin e prodhimit të cilat më së shumti përdoren që janë mazuti, gazi, nafta etj. Ne jemi të vetëdijshëm deri sot prodhuesit shumica absolute nuk ka pasur mundësi importimi e këtyre burimeve të energjisë për arsye të licencave të ndryshme, prodhuesit kanë qenë të detyruar të paguajnë tatimin e akcizës me rastin e blerjes së brendshme dhe më pas me paraqit një mori dokumentesh në Doganat e Kosovës bashkë me kërkesën për rikthim të mjeteve.

Tani pavarësisht a importon vet prodhuesi apo përmes kontraktorëve, prodhuesi do të lirohet nga tatimi i akcizës në kufi me rastin e importimit. Kjo përmes që e shkurton kohën përmes proceduarve burokratike dhe koston tani e tutje prodhuesit nuk do të kenë vështërsi edhe në likuiditet e tyre, po ashtu kjo procedurë dhe ky lirim nga tatimi i akcizës mundëson të gjithë prodhuesve që burimet e energjisë të lartë cekur të cilat i përdorin në procesin e prodhimit ti gjejnë në treg me një çmim më të lirë sesa kanë paguar deri më sot. Ky vendim do të krijoj efekt material nga data 1 Janar 2018 kur dhe fillon viti i ri fiskal që edhe buxheti i vitit të ardhshëm është përgatitur duke marrë në konsideratë këtë vendim.

Kryetari - theksoi se në parim vendimi mbështet prodhuesit vendorë dhe çdo heqje akcize dhe obligimeve tatimore do të gjejë mbështetjen e anëtarëve të komisionit.

Naser Osmani – pyeti për cilat produkte bëhet fjalë për lirim të tatimit të akcizës? Parimisht do ta kesh mbështetjen time dhe deputetëve. Kjo puna me naftën a keni menduar edhe mekanizmin e kontrollit të mos keqpërdorimit të kësaj sepse tashti cila kategori është e prodhuesve ku dihet që është edhe bujku, që e shfrytëzon naftën si energji për prodhim. Pyetja është a e keni menduar kontrollin që të mos keqpërdoret nga shitësit e derivateve të naftës?

Bedri Hamza – sqaroi se me shumë të drejtë gjatë këtij vendimi ne kemi marrë masa dhe kemi trajtuar me shumë kujdes këtë çështje. Qëllimi jonë ka qenë ne ti përkrahim prodhuesit,dhe kemi qenë shumë të kujdesshëm ti përkrahim prodhuesit që mos të krijohet hapësirë për prioritet në Dogana për evazion fiskal. Të gjithë prodhuesit janë të listuar dhe paraprakisht janë të regjistruar në AT dhe ,dihet kush janë prodhuesit të cilët i kanë numrat e identifikimit. Ndërsa ne po flasim vetëm për subjekte prodhuese jo për individuale.

Blerim Kuçi – theksoi se edhe pse duket pak e vrazhdët duhet ta sqarojmë dallimin e prodhuesit dhe bujqit individual,çka kuptojmë si prodhues si subjekt dhe individual? Me sa di unë përmes Ministrisë së Bujqësisë është njëfarë procesi i një lloji shifre të caktuar për bujqit të cilët janë të regjistruar. Kush hynë në kategorinë e prodhuesve apo fermerëve prodhues?

Bedri Hamza – sqaroi se lista e prodhuesve ekziston edhe sot dhe atë nuk e formon Ministra e Bujqësisë. Mund të futet një kompani si ndërmarrje prodhuese e cila merret me prodhimin, përpunimin e produkteve të caktuara që vijnë me bazë nga produktet që prodhohen në bujqësi. Pra, ne jemi duke folur ekskluzivisht vetëm për prodhues jo për bujqit individual.

Kryetari – pyeti a janë të liruar kontraktorët prej akcizës?

Bedri Hamza – sqaroi se kontraktorët nuk janë të liruar nga akciza.

Enver Hoti – vlerësoi se është një vendim i mirë i Qeverisë, po shqetësuese është pak gjendja. Unë do të dal pak jashtë teme, duke ditur që prodhuesit individual të bujqësisë janë prodhuesit më kryesorë në vend. Si do të ndodhë me ta për furnizimin e tyre me derivate, mendoj që kjo pak a shumë krijon njëfarë mundësie që të indikurajohen me punën e tyre nëse lihen anash.

Bedri Hamza – theksoi se kjo çështje është duke u diskutuar dhe është më mirë që të bëhet subvencionimi i tyre sesa që të lirohen nga akciza dhe TVSH. Sa i përket prodhuesve individual bujqëve ma e rrugës është që kur ata të dëshmojnë që kanë harxhuar atë sasi t'i rimburojnë apo t'i subvencionojnë nga pjesa e akcizës dhe obligimeve të tjera që lidhen me këtë produkt, sesa të lirohen nga akciza.

Naser Osmani – theksoi se kjo jep mundësi që prodhuesit individual që të regjistrohen të ardhmen në subjekte prodhuese që të shfrytëzoj këtë benefit. Deputeti Hoti kishte të drejtë që të bëhet një dallim në mes të prodhuesve, sidomos te sektori i bujqësisë që nuk është e drejtë.

Mërgim Lushtaku - kërkoj sqarim, sa e pash unë këtu mazuti paraqitet si lëndë e parë djegëse?

Bedri Hamza - sqaroi se mazuti specifikohet si lëndë djegëse, prodhuesit që përdorin burimet energjetike si lëndë djegëse.

Ali Lajçi - theksoi se dihet se ne kemi shumë norma e ligje e akte që janë bukur shumë të harmonizuara dhe janë në pajtueshmëri me rrjedhat integruese dhe evropiane. Mirëpo, mekanizmat tonë zbatues e kontrollues gjithherë kanë dal në nivelin bukur si periferik të çështjeve dhe kanë lejuar korrupsion dhe forma të tjetërsimit. Këtu duhet të merret një sugjerim përcjellja e mekanizmave zbatues ekzekutiv etj.

Bedri Hamza – zoti Lajçi unë gjithmonë do të bashkëpunojë me organet e rendit për ta parandaluar këtë dukuri dhe do të ketë ngritje të kontrollit dhe disiplinës tërë kohën.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisionit njëzëri nxori këtë

Përfundim

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa, përkrahu Propozim-Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 13/07, dt. 06.10.2017, për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit të Qeverisë nr. 16/20 të datës 24.03.2015, si vijon:
 1. Pika 7 e Vendimit nr. 16/20, i datës 24.03.2015, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndryshohet si vijon: lirohen nga tatimi i akcizës të gjithë prodhuesit që importojnë vet apo përmes kontraktuesve për nevoja të prodhuesve, të cilët janë të autorizuar nga Administrata Tatimore e Kosovës për shtyrje të TVSH-së për lëndë të parë, për të gjitha burimet e energjisë, të parapara me paragrafin 3 të Vendimit nr. 16/20, të datës 24.03.2015, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe atyre të parapara me Aneksin A të Ligjit nr. 03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-112 për tatimin e normës së akcizës në Kosovë, të cilat përdoren për qëllime të prodhimit.
 2. Doganat e Kosovës do të lirojnë subjektin e lartshënuar në pikën 2.1. të Vendimit Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 13/07, dt. 06.10.2017 për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit të Qeverisë nr. 16/20 të datës 24.03.2015, me rastin e deklarimit të mallit për doganim përmes Deklaratës Unike Doganore, dhe në rastet e importit nga kontraktori në pikën nr. 9 të deklaratës, do të vendoset emri dhe numri fiskal i prodhuesit i cili është i autorizuar nga Administrata Tatimore e Kosovës për shtyrje të TVSH-së për lëndë të parë. Doganat e Kosovës do të mbajnë evidencë të saktë përmes sistemit ASYCUDA, dhe për çdo lirim në kohë reale, do ta njoftojnë Administratën Tatimore të Kosovës, për qëllim të implementimit të legjislacionit në fuqi.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016

Bedri Hamza – theksoi se ky raport prezanton ekzekutimin e buxhetit nga institucionet e Republikës së Kosovës. Fillimisht sipas buxhetit fillestar plani vjetor i prodhimeve për vitin 2016, ka qenë 1 miliard e 895 milionë euro, ndërsa me rishikim të buxhetit planifikimit për total pranimet ishte rritur në 1 miliard e 978 milionë euro apo një rritje prej 83 milionë euro. Në anën tjetër plani vjetor i pagesave sipas buxhetit fillestar ka qenë 1 miliard e 773 milionë euro duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura nga viti 2015 deri në vitin 2016, ndërsa sipas rishikimit të buxhetit total pagesat ishin planifikuar të rriten në 1 miliard e 864 milionë euro një rritje prej 91 milionë euro.

Pranimet gjatë viteve 2016 duke përfshirë huamarrjet, grantet e përcaktuara të donatorëve dhe fondet në mirëbesim ishin në shumën prej 1 miliard e 779 milionë euro, kjo paraqet 90% të pranimeve të planifikuara sipas rishikimit të buxhetit ndërsa krahasuar me vitin e 2015 në total kemi një rritje prej 4%. Të hyrat tatimore të mbledhura nga Doganat e Kosovës kanë qenë me shumë 1 miliardë e 51 milion euro, në totalin e përgjithshëm të pranimeve këto të hyra marrin pjesë me 59%, ndërsa krahasuar me vitin paraprak realizimi është rritur për 9.4%. Të hyrat tatimore të mbledhura nga ATK-ja ishin me shumë prej 336 milionë euro, në totalin e përgjithshëm të pranimeve morën pjesë me 22%, krahasuar me vitin paraprak realizimi është rritur për 14%. Gjatë vitit 2016 janë rimbursuar 38 milionë euro për tatimpaguesit prej tyre nga Doganat e Kosovës 7.37 milion euro, ndërsa nga ATK-ja 31 milionë euro. Të hyrat jotatimore ishin me shumë prej 175 milionë euro në totalin e përgjithshëm të pranimeve këto të hyra morën pjesë me 10%, ndërsa për mbushjen në raport me planifikimin ka qenë e shkallës prej 83%. Të hyrat vetanake të nivelit qendror ishin në shumën prej 92 milionë euro ndërsa të hyrat vetanake të komunave 70 milionë euro, tatimi në pronë në vitin 2016 ka qenë në shumë prej 25 milionë euro apo një

rritje prej 21% krahasim me vitin paraprak. Të hyrat nga taksat koncensionale ishin me shumë prej 7.7 milionë euro pastaj kem të hyrat nga renta minerale 31 milionë euro, kthimet e kredive nga ndërmarrjet publike 7.2 milion euro. Të hyrat nga dividenda në vitin 2016 kanë qenë zero. Të hyrat e dedikuara ishin me shumë prej 9 milion euro. Total pranimet nga huamarrja ishin me shumë 154.4 milionë euro ose 9% e totalit të përgjithshëm të pranimeve nga të cilat institucionet financiare ndërkombëtare ishin 53.2 milion euro kurse letrat me vlerë 101.2 milionë euro.

Pagesat gjatë vitit 2016 duke përfshirë grantet e përcaktuara të donatorëve, pagesat e borxheve si dhe fondit në mirëbesim ishin me shumë 1 miliard e 763 milionë euro dhe paraqesin 95% të pagesave të planifikuara të krahasuara me vitin paraprak ishte një rritje prej 8.3%. Pagat dhe rrogat në total e përgjithshëm të shpenzimeve ishin me 31%, ndërsa me shumë ishin prej 544.8 milionë euro ose 99% e planit vjetor ndërsa dhe krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 3.5%. Mallrat dhe shërbimet në totalin e përgjithshëm të shpenzimeve morën pjesë 10% si shumë totale ishin 179.9 milion euro ose 99% e planit vjetor krahasuar me vitin paraprak në këtë kategori kemi pasur ulje prej 2.8%. Shpenzimet komunale morën pjesë me 1% në shpenzimet e përgjithshme apo 23.4 milion euro ku është plotësuar 94% e planit vjetor krahasuar me vitin paraprak kemi pasur ulje me 3.4%. Subvencionet dhe transferet në totalin e përgjithshëm të shpenzimeve marrin pjesë 27% që janë me shumë prej 475 milionë euro 99% të planit vjetorë të krahasuar me vitin paraprak kemi pasur një rritje prej 11%. Shpenzimet kapitale në totalin e shpenzimeve të buxhetit morën pjesë me 26% janë 452.3 milionë euro ose 90.5% të ekzekutuara në raport me planin vjetor, ndërsa krahasuar me vitin paraprak kemi pasur një rritje prej 10%. Shpenzimet për servisimin e borxhit në totalin e shpenzimeve të përgjithshëm morë pjesë me 5% janë me shumë 35.2 milionë euro ose 93% të planit vjetor.

Grantet e përcaktuara të donatorëve 22.15 milion euro, ku përfshihen 8.74 milionë euro të pranuar gjatë vitit 2016, ndërsa 10.1 milion euro të bartura ka viti paraprak, si dhe 3.3 milion euro donacione në formë të pagesave direkte. Nga ky fond gjatë vitit 2016 janë bërë shpenzime me shumë prej 14.9 milionë euro që rezultoi me bartjen për vitin 2017 e 7.3 milion euro. Pasuria financiare me para të gatshme 31.12.2016 ishte 271.2 milion euro. Pjesë e këtij bilanci ishin fondet e qëllimeve specifike si fondi i donatorëve 7.3 milion euro, të hyrat vetanake të bartura 27.2 milionë euro, të hyrat e dedikuara 0.8 milion euro, fondi zhvillimor i mirëbesimit 10.1 milion euro dhe fondet tjera 13.1 milion euro. Fondet e pashpenzuara me 31 Dhjetor 2016 ishin me 212.8 milionë euro.

Safete Hadërgjonaj – theksoi se është shqetësuese tejkalimi i buxhetit nëpër komuna, si dhe obligimet e papaguara të komunave të cilat nuk janë duke përfunduar me kohën, kjo nuk është mirë për institucionet tona. Shqetësuese pse rritet numri të punësuarve me krahasim me atë që është planifikuar në buxhet. Dua të dijë sa janë të punësuar me kontrata në vepër dhe çfarë ka ndodhur më tutje me ta? Nëse ka ndryshim në ligj duhet të vijë dhe të miratohet në kuvend dhe jo të shkelet ligji.

Enver Hoti – theksoi se sa i përket dividendës është zero, është mirë që të dihet pse ka ulje të kësaj? Është mirë që ti trajtojmë këto çështje dhe mos ti lejojmë anash.

Bedri Hamza - Deputetja Hadërgjonaj theksoj shumë qartë dhe me të drejtë që nuk mund të rritet numri i punësuarve që të tejkalohej buxheti, kushdo që ka bërë këtë shkelje ka bërë shkelje të ligjit. Duke parë situatë financiare dividenda po ashtu do të jetë zero në vitin 2018.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni me gjashtë vota për, një abstenim dhe asnjë kundër, Komisioni nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2016

Fehmi Mehmeti – raportoi se gjatë vitit 2016 BQK ka arritur me sukses të realizoj objektivat e saja ligjore. Norma reale e rritjes ekonomike gjatë vitit 2016 ishte 4.1%, kjo rritje e aktivitetit ekonomik është gjeneruar nga rritja e investimeve prej 7.5% dhe rritja e konsumit prej 2.9%, ku kontribut të rëndësishëm kanë dhënë edhe rritja e aktivitetit kredihënës nga institucionet financiare në vend. Në anën tjetër neto eksportet kanë filluar negativisht në rritjen ekonomike. Sfida kryesore e vendit mbetet ende ndihma nga vendet e jashtme të importit dhe niveli ulët i eksportit. Rritja e vlerës së importit me 5.9% dhe rënia e eksportit me 4.8% bëri që deficitin tregtar në vitin 2016 të arrijë në 2.5 miliard euro apo 40.9% me raport me bruto produktet vendore. Deficitin i lartë tregtarë vazhdon të jetë kontribuues kryesorë i deficitit të llogaris rrjedhëse dhe kapitale që në vitin arriti 534.6 milion euro apo 8.8% e bruto produktit vendorë. Në vitin 2016 vlera e gjithëj kredive arrin 2.2 miliard euro që paraqet një rritje vjetore prej 10.4%.

Safete Hadërgjonaj – theksoi se rënia e investimeve të huaja direkte është shumë shqetësuese për vendin tonë. Është shqetësuese edhe fondi i pensioneve e cila ka kaluar në 1 miliard euro dhe ato mjete nuk mund të shfrytëzohet nga Institucionet e Kosovës. Më së shumti është shqetësuese norma e lartë e interesit tek institucionet mikrofinanciare. Më intereson të dijë pse norma e interesit në bankat mikrofinanca të jetë aq e madhe? Këto norma të larta të interesit dëmtojnë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Naser Osmani – theksoi se në këtë raport do të dëshiroja që të shohim likuiditetin e bankave komerciale, shqetësuese është norma e lartë e kredive. Është shqetësuese edhe mos zgjidhja e kartonit të gjelbërt që një kohë të gjatë ku dihet kompanitë e sigurimeve arrijnë një fitim të madh në këtë proces.

Fehmi Mehmeti – sqaroi se sa i përket investimeve të huaja direkte në vitin 2017 ka përmirësim të dukshëm me vitin paraprak ku kemi një rritje mbi 50% dhe po ashtu kemi rritje të eksporteve mbi 20%. Sipas fondit pensional, sipas ligjit e dimë që vetëm 30% lejohet të investohet në Kosovë, kurse pjesa tjetër e jashtme. Sa i përket kartonit të gjelbërt ne nuk kemi ndenjur duarkryq, ku kemi kontaktuar me Sllovenin dhe Kroacinë, ku kemi kërkuar që ta shesim kartonin e gjelbërt por Sllovenia kërkon garanci prej shtetit që në rast se kanë problem me pagesën e dëmeve atëherë shteti i Republikës së Kosovës të garantojë që t'i paguajë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni me gjashtë vota për dhe një abstenim nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2016.

6. Shqyrtimi i Raportit financiar të Avokatit të Popullit për vitin 2016

Kryetari – në vazhdim kemi shqyrtimin e raportit financiar të Avokatit të Popullit për vitin 2016. Paraprakisht falënderoj Avokatin e Popullit për punën e bërë në çështjen e energjisë së zyrës së rregullatorit.

Hilmi Jashari – theksoi se dihet se me ligj është rregulluar që buxheti i Avokatit të Popullit duhet të jetë më i lartë se i vitit paraprak ku është futur kusht për liberalizimin e vizave. Ne kemi gjetur një rrugë tjetër që të mos pengojmë zhvillimin e procesit në vend dhe të liberalizimit të vizave kemi arritur një

marrëveshje me ministrin ku ai do të nxjerr një vendim ku ai do të sigurojë rritjen e buxhetit të Avokatit të Popullit vetëm nëse ka nevojë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin financiar të Avokatit të Popullit për vitin 2016.

7. Shqyrtimi i Propozimit të Komisionit për Përzgjedhje të anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Kryetari – theksoi se Komisioni për Përzgjedhje ka zhvilluar procedurat për përzgjedhjen e pozitave të lira për anëtar të Bordit Drejtues të Fondit Pensional dhe i ka propozuar Kuvendit kandidatët për emërim sipas Ligjit për fondet pensionale të Kosovës.

Enver Hoti - kërkojë që të refuzohen këta dy kandidatët e propozuar për një pozitë, sepse këta kandidat nuk janë adekuat për këtë pozitë. Prandaj unë jam kundër këtyre kandidatëve.

Safete Hadërgjonaj - sipas mendimit tim këta kandidat nuk kanë arsye të refuzohen sepse këta kandidat nuk kanë shkelje ligjore. E dërgojmë në Kuvend rekomandimi dhe më pas Kuvendi vendos se a do t'i zgjedh këta kandidat po ose jo.

Blerim Kuçi – theksoi se është shqetësuese në njërin prej kandidatëve i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës të futet në garë për anëtarë të bordit. Vërejtja e ime është që për të ardhmen të ndryshohet ligji që të mos i lejojmë shtetasve të huaj të kandidojnë për anëtarë të bordeve, por t'iu japim më shumë raste shtetasve të Republikës së Kosovës.

Kryetari – theksoi se deri sa e rregullon ligji atëherë ai ka të drejtë ligjore të jetë kandidat. Komisioni nuk e përzgjedh kandidatin por në fund Kuvendit do ta ketë fjalën e fundit.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni me pesë vota për, dy kunder dhe një abstenim nxori këtë

Rekomandim

1. I rekomandohet Kuvendit, që me votim të fshehtë, të emërojë një anëtar të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, nga dy kandidatët e propozuar nga Komisioni për Përzgjedhje, në vijim:

**Hajdar Korbi,
Mark Crawford.**

2. I rekomandohet Kuvendit, që me votim të fshehtë, të emërojë një anëtar të Bordit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për përfaqësimin dhe këshillimin e punëdhënësve në Kosovë, nga tre kandidatët e propozuar nga Komisioni për Përzgjedhje, në vijim:

**Valdrin Kasumaj,
Flamur Keqa,
Ejup Qerimi.**

3. Mandati i anëtarëve të emëruar në Bordin Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale, është katër vjeçar, në pajtim me nenin 4.6. të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115, Ligjin nr. 04/L-168 dhe Ligjin nr.05/L-116.

8. Të ndryshme

Kryetari - njoftojë anëtarët se Punëtorinë e organizuar nga GIZ, do ta mbajmë me 1 dhjetor, prej orës 9 deru në ora 17.

Mbledhja përfundoi në ora 13:00

Përgatitur nga Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Lumir Abdixhiku